



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:160444

Datë: 01.12.2022

Numri i dokumentit: 03701650

C.nr.1000/2020

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtorin profesional Agon Halabaku, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, N.A. nga fshati, Komuna e Vitisë, e përfaqësuar me autorizim nga T. A., avokat nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Vitisë - DKA, e përfaqësuar nga Ekrem Shabani, Zytar Juridik, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, vlera e 2,037.20 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 14.11.2022, jashtë seance, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.A., kundër të paditurës Komuna e Vitisë - DKA dhe, detyrohet e paditura që paditëses, për shpërblimin jubilar, për 10 vjetë të përvojës së punës, t'ia paguaj 50% të pagës bazë, shumën prej 210.50 Euro, për shpenzime të ushqimit ditor, për periudhën 18.04.2017 deri me 31.10.2022, për 667 ditë të pranisë në punë, t'ia paguaj shumën prej 1, 334 Euro dhe për shpenzime të udhëtimit për 327 ditë, shumën prej 228.90 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1,773.4 Euro me kamatë ligjore prej 8% në vit, e llogaritur nga data e nxjerrjes së aktgjykimit deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. Refuzohet si e pa bazuar, pjesa e kërkesës së paditëses për pagimin e shpenzimeve të ushqimit për 120 ditë në shumë prej 240 Euro dhe të udhëtimit për 34 ditë, në shumë prej 23.80 Euro, për periudhën kohore data 14.09.2020 deri me 21.01.2021.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270 Euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësja N.A., përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, me padinë e datës 17.11.2020, të saktësuar me parashtrësën e datës 11.11.2022, si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor¹ ka kërkuar nga Gjykata, t'ia aprovojë kërkesëpadinë dhe të detyrohet e paditura DKA – Komuna e Vitisë që paditësit, për shpërblim jubilar, për përvojën e punës mbi 10 vjet, t'ia paguaj 50% të një page bazë, në shumë prej 210.50 Euro, për shpenzime të ushqimit ditor, për periudhën 18.04.2017 deri me 31.10.2022, për 787 ditë të pranisë në punë, t'ia paguaj shumën prej 1,574 Euro dhe për shpenzime të udhëtimit, për periudhën e njëjtë, për 361 ditë t'ia paguaj shumën prej 252.70 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 2,037.20 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e

¹ Gjykata ka caktuar seancë përgatitore dhe pas propozimit të përfaqësuesve të palëve, ka kaluar në shqyrtim kryesor të çështjes.

parashtrimin të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

Bazën ligjore të kërkesëpadisë, paditësi e mbështeti në nenin 35, par. 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në fuqi nga data 18.04.2017 për shkak se, paditësja, është e punësuar si mësimdhënëse në SHFMU “” në, dhe në SHFMU “” në dhe për periudhën 18.04.2017 deri me 31.10.2022, ka qenë e pranishme në punë 787 ditë. Përkundër kërkesës në procedurë jashtëgjyqësore, e paditura i është përgjigjur negativisht në kërkesat e tij. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar: për përpilim të padisë shumë prej 104 Euro, për një seancë të mbajtur gjyqësore, vlerën prej 135 dhe për taksë gjyqësore, vlerën prej 31 Euro, në shumë e përgjithshme prej 270 Euro.

E paditura, në përgjigje në padi, nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, por ka theksuar se beneficinet që i parashih Kontrata Kolektive nuk mund të paguhen nga buxheti komunal, pasi ky buxhet është i pamjaftueshëm për mbulimin e këtyre shpenzimeve. Edhe në seancën përgatitore ka mbetur pranë qëndrimeve si në përgjigje në padi, duke shtuar se për të paditurën nuk është kontestuese marrëdhënia e punës dhe ditët e pranisë në punë, por kontestuese është baza ligjore për kërkesat nga data 20.04.2020 deri më 21.01.2021, në të cilën periudhë kohore, Kontrata Kolektive nuk ka qenë në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Kërkesën drejtuar DKA-së, e datës 12.11.2020, Përgjigja e DKA-së, e datës 31.11.2020, Vërtetimet e shkollës SHFMU “”i, të datave 08.11.2022, me numër të protokollit 51/22 dhe 52/22, Vërtetimet e SHFMU “” në, të datave 09.11.2022, Lista e pagave, vërtetimin e çmimoreve së biletave dhe certifikatën e vendbanimit.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-së, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses N.A. është pjesërisht e bazuar.

Nga provat materiale të administruara dhe nga qëndrimi i palëve në procedurë, gjykata vërtetoi se, paditësja është në marrëdhënie të punës si mësimdhënëse në SHFMU “” në dhe SHFMU “” në, , dhe për periudhën 18.04.2017 deri me 31.10.2022, paditësja ka qenë e pranishme në punë 787 ditë.

Faktet për marrëdhënien e punës, ditët e pranisë së paditësit në punë dhe fakti se paditësja udhëton në relacionin e paraqitur nuk u kontestuan nga e paditura, e po ashtu u vërtetuan një nga një me Vërtetimet e SHFMU “”, të datave 09.11.2022 dhe me Vërtetimet e SHFMU “”, të datave 08.11.2022, me numër të protokollit 51/22 dhe 52/22, dhe çmimorës së biletave. Gjithashtu, nuk u kontestua as përvoja e paditësit në punë, mbi 10 vjet, e cila u vërtetua edhe në bazë të Listës së pagave.

Baza ligjore

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: ”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektivë duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”,

ndërsa, në me paragrafin 5 përcaktohet se, “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”.

Me nenin 35, par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 18.04.2017, është përcaktuar se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit, ndërsa me nenin 35, par. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 18.04.2017, është përcaktuar se “kompensimi i shpenzimeve për punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”. Kurse me nenin 35 parag.8 pika 8.1 të kësaj kontrate është përcaktuar se, “Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: [...] për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë 50 % të një page bazë [...]”.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, e po ashtu në bazë të nenit 245, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me Nr.04/L-077, ku përcaktohet se “Kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbatjen e tij”, gjykata e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e detyroj të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi gjykata vërtetoi se paditësja është e punësuar të e paditura, dhe gjatë periudhës si në dispozitiv të aktgjykimit ka qenë e pranishme në punë, kërkesat për shpenzime të ushqimit dhe shpenzime të udhëtimit, u gjykuan si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit. Me qëllim të zbatimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, gjykata nuk caktoi ekspert financiar pasi që shumica e përgjithshme për pagesë u bë sipas përlllogaritjes së thjeshtë dhe nuk u kundërshtua nga përfaqësuesi i të paditurës.

Ndërsa, sa i përket pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë, në shumë prej 240 Euro e kërkuar për shpenzime të ushqimit, për 120 ditë, dhe për shpenzime të udhëtimit, për 34 ditë, shumën prej 23.80 Euro, për periudhën nga data 14.09.2020 deri më 21.01.2021, Gjukata, e bazoi në faktin se nuk kishte bazë ligjore, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit ka skaduar me date 18.04.2020, andaj edhe vendosi si në pikën II të dispozitivit.

Pretendimi i përfaqësuesit të paditëses se Kontrata Kolektive në nenin 45 ka paraparë vazhdimin e kontratës kolektive edhe për një vit, pasi asnjëra nga palët kontraktuese nuk është tërhequr, u gjet i pa bazuar, sepse neni 90 paragrafi 4 i Ligjit të Punës 03/L-21, përcakton “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”.

Gjukata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës dhe të bazuara i gjeti vetëm pretendimet sa i përket periudhës gjatë të cilës Kontrata Kolektive nuk ka qenë në fuqi.

Lidhur me kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së, i cili përcakton se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitorin, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që e paditura e ka humbur kontestin në këtë rast, andaj edhe e detyroi që paditësit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270 Euro edhe atë: për përpilimin e padisë 104 Euro, për

taksë gjyqësore 31 Euro si dhe për një seancë gjyqësore 135 Euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifat e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 1000/2020, datë 14.11.2022

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.